



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Pogradec, më 08.10.2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data: 08.10.2021

Drejtuar: OE **“Rej” shpk** me Nipt J93711608Q me adresë: Tirane Zogu i Zi, Qatar Center, kati 2. si dhe me administrator z.Luan Kapri, me vlerën e ofertës **54 104 630 (pesëdhjetë e katër milion njëqind e katër mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh.**

Procedura e prokurimit/lotit: **“E Hapur”, “Punë”, “Prokurim me mjete elektronike”.**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF- 95477 -05-14-2021**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Rehabilitim i Rrugës së Rrodokalit, Njësia administrative Proptisht” me fond limit: 58 333 330 (pesëdhjetë e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë) lekë pa tvsh** me burim financimi “Buxheti i Shtetit” sipas VKB nr.39 datë 19.04.2021, konfirmuar me shkresën e Prefektit nr.398/1 prot, datë 26.04.2021.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: **16 muaj sipas grafikut të punimeve,** duke filluar nga dita e nesërme e marrjes në dorëzim të sheshit të ndërtimit.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. "Company Riviera 2008" shpk me Nipt K81716011V

Vlera e ofertës: 32 192 003 (tridhjetë e dy milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e tre) lekë pa tvsh.

2. BOE :“Eurondërtim 2000” shpk me Nipt K02003001O & **“Almo Konstruksion” shpk** me NIPT J91915001P

Vlera e ofertës : 53 100 940,10 (pesëdhjetë e tre milion e njëqind mijë e nëntëqind e dyzet presje dhjetë) lekë pa tvsh.

3. BOE : “Infinit” shpk me Nipt J74304623M & “SIRETA 2F” shpk me Nipt K51501008J

Vlera e ofertës: 41 760 122 (dyzet e një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e dy) lekë pa tvsh.

4. “Leon Konstruksion“ shpk me Nipt K718200091

Vlera e ofertës :49 555 556,46 (dyzet e nëntë milion e pesëqind e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë presje dyzet e gjashtë) lekë pa tvsh.

5. “Rej” shpk me Nipt J93711608Q

Vlera e ofertës :54 104 630 (pesëdhjetë e katër milion njëqind e katër mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. "Company Riviera 2008" shpk me Nipt: K81716011V,me ofertë me vlerë 32 192 003

(tridhjetë e dy milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e tre) **lekë pa tvsh**, për arsyet e mëposhtme:

Oferta me vlerë 32 192 003 (tridhjetë e dy milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e tre) lekë pa tvsh,, eshte anomalisht e ulët në lidhje me punët eofruara, pasi :

$$\frac{\text{oferte}}{\text{fond limit}} \times 100\% = \frac{32\,192\,003}{58,333,330} \times 100\% = 56\%$$

Pra nga perlllogaritjet rezulton se oferta e shoqerise "Company Riviera 2008" shpk te jete ulur me shume se 25% e fondit limit dhe praktikisht te jete oferte anomalisht e ulet.

Oferta e paraqitur nga "Company Riviera 2008" shpk refuzohet sepse edhe pas shqyrtimit te informacionit te paraqitur nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Konkretisht;

Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se ;.... Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni I vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Referuar praktikës se vendimeve të KPP , rezulton se:

Argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor.

Së pari, operatori ekonomik duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara,

Se dyti, duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara,si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve.

se treti, është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi,

Se katerti, duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

Katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "Company Riviera 2008" shpk k në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Akoma edhe më tej, referuar shkresës datë 22.06.2021 "Kthim pergjigje per oferte anomalisht e ulet" së paraqitur nga operatori "Company Riviera 2008" shpk rezulton te jete deklaruar se: Një ndër komponentët më të rëndësishëm dhe që ndikon më së shumti në ofertë janë materialet që do të përdoren në vepër. Për këtë arsye të gjitha materialet e nevojshme studiuam tregun, kërkuam oferta dhe na ofruan cmime të favorshme.....
ndërkohë që nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të vërtetuar këtë fakt.

KVO vëren se "Company Riviera 2008" shpk, përveç argumentimit të vet në formën e një preventivi vetdeklarativ (analize cmimesh), nuk ka paraqitur prova shkresore për elementet e ofertës sikurse kërkuar dhe përcaktohet në nenin 56 të LPP.

Operatori ekonomik ka detyrimin ligjor që të prezantojë me dokumentacion provues zgjidhjet teknike dhe/ose ndonjë kusht favorizues që do të garantonin realizimin e punimeve pranë autoritetit kontraktor.

Paraqitja vetem e deklaratës dhe zërave të preventivit i pashoqëruar me dokumentacionin shtesë provues nuk mund të konsiderohet si provë, pasi në vetvete nuk provon dhe garanton ofertën ekonomike si dhe realizimin e punimeve.

Gjithashtu nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar, nga ana e ofertuesit nuk rezulton të jenë parashtruar të dhëna, fakte apo garanci për origjinalitetin e punimeve në referim të gurmës ç, neni 56 pika 2, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, pasi provueshmëria e këtij kriteri është esenciale duke garantuar autoritetin kontraktor jo vetëm për realizimin e punimeve, por për realizimin e tyre sipas standarteve të kërkuara në cilësi dhe volum dhe me çmimin konkures të ofertuar.

Akoma edhe me tej ;

Analiza cmimeve është kërkuar nga autoriteti kontraktor pikërisht për krijimin e bindjes për realizimin me sukses të kontratës edhe me vlerën e ofertuar e cila rezulton anomalisht e ulët. Me anë të dokumentacionit të paraqitur operatori nuk ka mundur të krijojë bindjen tek KVO lidhur me këtë fakt

1. Analizat e paraqitura nga ana juaj për të gjitha zërat e punimeve kanë mangësi sepse në analizë ku thote shpenzime plotesuese 8% dhe fitimi 10 % ju nuk i keni llogaritur me kete formule por me një përqindje tjetër të cilën ju nuk e keni vendosur.
 2. Bashkëngjitur këtij process verbali po vendosim analizë e hartuar nga ana juaj dhe korigjimi i bërë nga ana jonë. Me ngjyrë të verdhë kemi shënuar çmimin e dale nga analiza e operatorit ekonomik dhe me jeshile çmimi real sipas llogaritjes sipas VKM së sipër cituar.
 3. Ju citoni se baza materiale, furnizimi dhe prodhimi i tyre është studiuar nga kompania juaj dhe se materialet e nevojshme do ti blini me çmime të favorëshme për të cilat ju nuk keni paraqitur asnjë faturë apo ofertë nga furnizuesi.
- Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, KVO gjykon se , nga ana e operatorit

ekonomik "Company Riviera 2008" shpk – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Skualifikimi për arsyet e përmenduar më sipër, në fakt është respektim nga KVO-ja i praktikës së vendimarrjeve të KPP si organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, vendimet e të cilit janë të detyruara për zbatim nga cdo AK që prokuron fonde publike. Konkretisht vendimet K.P.P.518/2016, K.P.P.453/2016; K.P.P.771/2016

Për sa më sipër, oferta e "Company Riviera 2008" shpk skualifikohet sepse kjo ofertë nuk është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. - Faza: Vlerësim financiar.

2.BOE “Eurondërtim 2000” shpk & “Almo Konstruksion” shpk me Nipt: K020030010 & Nipt: J91915001P me vlerën e ofertës : **53 100 940,10** (pesëdhjetë e tre milion e njëqind mijë e nëntëqind e dyzet presje dhjetë) **lekë pa tvsh** për arsyet e mëposhtme:

1. Ka mungesë dokumentacioni për sa i përket kushtit të vendosur në DST pika 2.3.9, konkretisht i mungon Leja Mjedisore III.1.B
2. Rezulton që ka mungesë dokumentacioni sipas pikës 2.3.8, konkretisht Autobotit të ujit i mungon certifikata e transportit lëshuar nga njësi vendore, kriter I kërkuar në DST.
3. Rezulton që ka mungesë dokumentacioni sipas pikës 2.3.8, konkretisht Autovincit i mungon certifikata e transportit lëshuar nga njësi vendore, kriter I kërkuar në DST.

1. Oferta ekonomike nuk është depozituar në emër të bashkimit të Operatorëve.

3.“Leon Konstruksion“ shpk me Nipt: K718200091 me vlerën e ofertës : 49 555 556,46 (dyzet e nëntë milion e pesëqind e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë presje dyzet e gjashtë) **lekë pa tvsh**, për arsyet e mëposhtme:

1. Ka mungesë dokumentacioni për sa i përket kushtit të vendosur në DST pika 2.3.9, konkretisht i mungon Leja Mjedisore III.1.B.
2. Ka mungesë dokumentacioni sipas pikës 2.3.8, konkretisht Autobitumatrices i mungon leja e transportit lëshuar nga njësi vendore, kriter i kërkuar në DST.

4.BOE : “Infinit” shpk me Nipt J74304623M & “SIRETA 2F” shpk me Nipt K51501008J me vlerën e ofertës : 41 760 122 (dyzet e një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e dy) lekë pa tvsh, për arsyet e mëposhtme:

1.Sipas vendimit të KPP-se me Nr.633/2021 Prot. Date 15/09/2021 citojme: Sipas kriterëve të kualifikimit është kërkuar Leje me kodin III.1.B me përshkrim të veprimtarisë “Magazinin mbetjesh” ndërsa sipas dokumentacionit të dorëzuar në spe nga operatori “INFINIT”SHPK rezulton se është dorëzuar Leje me emërtimin “Rikuperim i mbetjeve jo të rrezishme”. Pra një veprimtari e ndryshme nga ajo që është kërkuar në kriterin e vecante të kualifikimit.

Gjithashtu nga verifikimi i ekstraktit tregtar per te dhenat e oe “infini”shpk, komisioni konstatoi se:Objekti i aktivitetit eshte grumbullim transport dhe riciklim i mbetjeve jo te rrezikshme dhe jo sipas veprimtarise se kerkuar ne kriterin e vacante te kualifikimit.Per me teper oe “infini”shpk ne argumentet qe ka derguar ne shkresen nr.1281 .3 date 13.07.2021 ne KPP nuk ka sjelle asnje dokumentacion provues apo argument ne lidhje me disponimin e lejes me Kodin III.1.B me pershkrim veprimtarie”Magazinin mbetjesh”.Neni 92.3 e LPP-se :3. *Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*”

Ne rastin konkret KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga oe ne proceduren e prokurimit nuk i ploteson kerkesat e AK dhe nuk konsiderohet i vlefshem.
Rrjedhimisht,pretendimi i oe ankimues qendron.

Pra sipas KPP-se bashkimi operatoreve ekonomik “Infini”shpk dhe “Sireta 2F”shpk skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: **OE “Rej” shpk** me Nipt J93711608Q me adresë: Tirane Zogu i Zi, Qatar Center, kati 2. si dhe me administrator z.Luan Kapri, me vlerën e ofertës **54 104 630 (pesëdhjetë e katër milion njëqind e katër mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh**, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *autoritetit kontraktor Bashkia Pogradec* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes / publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 29.06.2021.

Ankesa: ka ose jo: _Po, Ankesa nr. 3175 prot, date 08.07.2021

Ne date 12.07.2021 paraqiten argumente kunder nepermjet shkreses nr. 3175/2 Prot.

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë: Kane marre pergjigje ne date 19.07.2021 me shkresat me nr. 3175/4 dhe 3175/5 prot.

Njoftimi i RiKlasifikimit eshte bere ne date 28.09.2021 bazuar ne Vendimin e Formes se Prere nr 633/2021 prot., Date 15.09.2021 te Komisionit te Prokurimit Publik.

KRYETAR
Ilir XHAKOLLI

**(PERSONI I AUTORIZUAR NË USHTRIM
TË KOMPETENCAVE TË DELEGUARA)
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Klajda GUSHO**